



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. _____ Prot

Tiranë, më __/__/2010

UDHËRRËFYES
I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE
Për Kontrolluesit dhe Përpunuesit

PËRMBAJTJA

A. Mbrojtja e të dhënave nga Kontrolluesit e Përpunuesit		faqe
I. Përpunimi i të dhënave të zakonshme	“	6
Mbrojtja	“	6
Kriteret	“	7
Siguria	“	7
Zbatimi i të drejtave të subjektit	“	8
Përgjegjësia për të njoftuar	“	11
Konfidencialiteti	“	11
II. Përpunimi i të dhënave sensitive		
Mbrojtja	“	11
Kriteret	“	12
Siguria	“	13
Zbatimi i të drejtave të subjektit	“	14
Përgjegjësia për të njoftuar	“	14
Konfidencialiteti	“	15
III. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave		
Mbrojtja	„	15
Kriteret	“	15
Siguria	“	17
Zbatimi i të drejtave të subjektit	“	18
Përgjegjësia për të njoftuar	“	18
Konfidencialiteti	“	18
B. Mbrojtja e të dhënave nga Kontrollues të veçantë		
Statusi i kontrolluesit	“	19
Mbrojtja	“	19
Kriteret	“	20
Siguria	“	21
Zbatimi i të drejtave të subjektit	“	22

Konfidencialiteti	“	24
-------------------	---	----

C. Mbrojtja e të dhënave nga Autoriteti Mbikëqyrës

Vënia në lëvizje	“	24
Detyrat e Komisionerit	“	25
Aktet ligjore e nënligjore	“	27

UDHËRRËFYES

I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Për Kontrolluesit dhe Përpunuesit

Ky material është një çelës në ndihmë të Kontrolluesve e Përpunuesve të të dhënave personale, si dhe punonjësve të Zyrës së Komisionerit, për të hyrë, njohur dhe zbatuar rregullat parësore të mbrojtjes së të dhënave personale, privatësisë dhe të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Për mbrojtjen e të dhënave personale ekziston një legjislacion i gjerë vendas dhe ndërkombëtar, i cili duhet të jetë në bazën e punës të Kontrolluesve dhe Përpunuesve dhe punonjësve të zyrës së Komisionerit.

Akte ndërkombëtare

- Deklarata Universale e të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokolli nr.11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998.
- Direktivat 95/46/EC e Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian dhe 2002/58/EC.
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”, ratifikuar me Ligjin nr.9288, datë 7.10.2004.
- Protokolli shtesë i Konventës së KE “Për Mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale”, ratifikuar me ligjin nr.9287, datë 7.10.2004.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garantohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare. Ky nen parashikon:

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përfshinë në privatësi një rreth të gjërë të dhënash personale.

Me të dhëna personale kuptojmë: Çdo gjë, e dhënë dhe informacion që lidhet me personin, me jetën e tij private, të drejtat, prona, mjedisi që lidhet me pronën, banesa e pjesët e saj, veprimtaria dhe interesat vetiake, e drejta e votës, shprehja e fjalës, veshja, paraqitja e jashtme, fotografia, hobet, shijet, dhuntitë, cilësitë e veçanta, aftësitë, çështjet e brendshme të familjes, të dhënat sensitive (jeta e prekshme, shqisore, intime, e ngushtë, vemesa e brendshme e njeriut, origjina racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimi në sindikata, besimi fetar apo filozofik, dënimi penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale), tiparet biologjike unike (vetitë, ngjyra e syve, flokëve, ngjyra e lëkurës, përmasat e format e pjesëve të trupit, zëri, ecja), të dhënat biometrike (gjurmët e gishtërinjëve, imazhe të retinës, gjeometria e fytyrës ose duarve, irisit), karakteristikat gjenetike etj.

Sipas nenit 3 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” e dhënë personale është informacioni që mundëson identifikimin e një personi të caktuar. Pra, si element të të dhënave personale në privatësi përfshihen;

Emri, mbiemri, datëlindja, adresa postare ose e e-mail, numri i telefonit, numri identifikues i taksave, numri i patentës, shenjat e gishtërinjëve, ADN-ja, fotografitë, numri i sigurimeve shoqerore të dhëna këto që identifikojë individët, qoftë direkt ose indirekt.

Praktikisht çdo gjë që bëjmë në jetën tonë të përditshme kërkon ofrimin e të dhënave personale.

Ne i japim të dhënat tona kur hapim një llogari bankare, regjistrohemi për një kurs gjuhe, regjistrohemi në një palestër, aplikojmë për të marrë pjesë në një konkurs, rezervojmë një fluturim apo hotel, bëjmë një takim me mjekun, kërkojmë për punë ... çdo herë që paguajmë me kartë krediti ose lundrojmë në Internet. Ne lëmë pas një mori gjurmësh të të dhënave në të gjitha këto aktivitete.

Mekanizmat e përdorur për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat personale janë në evoluim të vazhdueshëm.

Kjo do të thotë se zhvillimi dhe aplikimi i teknologjive të reja kanë sjellë lehtësi dhe shpejtësi më të madhe në shkëmbimin e të dhënave, dhe si pasojë ka shkaktuar një rritje të numrit të përpunimit të të dhënave që janë bërë çdo ditë. Megjithëse është e pamohueshme që këto teknologji kanë përsheptuar përparimin në shoqëritë moderne dhe kanë rritur cilësinë e jetës për publikun në përgjithësi, duhet të ketë gjithashtu një ekuilibër mes modernizimit dhe garantimit të të drejtave të qytetarëve.

Ky kufi delikat mes të drejtës së qytetarëve për të ruajtur kontrollin mbi të dhënat e tyre personale dhe aplikimit të teknologjive të reja kompjuterike përbëhet nga konteksti në të cilin Ligj-bërësit kanë vendosur të drejtën themelore për mbrojtjen e të dhënave personale.

A. Mbrojtja e të dhënave nga Kontrolluesit e Përpunuesit

I. Përpunimi i të dhënave të zakonshme

Rregulla të detyrueshme

Sipas nenit 3/3 të ligjit “Kontrollues”, *pra personi përgjegjës- është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale (çdo organ qendror dhe vartës të tij në qendër apo gjetkë, që ushtrojnë autoritetin më vehte, sipas ligjit, aktit nënligjor apo statutit, rregulloreve, kontratave etj.).*

1. Mbrojtja (neni 5)

Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- ç) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, në përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret (neni 6)

Të dhënat personale përpunohen vetëm:

- a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;
- b) për hartimin dhe përmbushjen e kontratave, në të cilat subjekti i të dhënave personale është palë;
- c) për të mbrojtur interesat jetikë të subjektit të të dhënave;
- ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- d) për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- dh) për ndjekjen e interesave legjitime të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.

3. Siguria (neni 27)

3.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

3.2 Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;

b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;

c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar;

dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3.3. Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.

3.4 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.5 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

3.6 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.

4. Zbatimi i të drejtave të subjekteve (nenet 12-17)

E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave(neni 18)

1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër, i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale. Ky informacion nuk jepet, nëse subjekti i të dhënave ka dijeni për të.

2. Të dhënat mund të mblidhen nëpërmjet transmetimit nga një përpunim tjetër, i kryer nga i njëjti kontrollues ose kontrollues të tjerë. Në këto raste, informacioni nuk do të jepet, kur përpunimi i të dhënave është parashikuar nga ligji, kur është e pamundur dhënia e informacionit, për shkak se nuk mund të gjendet subjekti i të dhënave, ose kur të dhënat përpunohen sipas pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.

E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave(neni 26 e 31)

Komisioneri krijon një regjistër për dokumentimin e të gjitha njoftimeve dhe autorizimeve, që ai kryen në ushtrim të kompetencave të tij, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, i cili është i hapur për njohje për çdo person.

E drejta për akses

1. Çdo person ka të drejtë që, me kërkesë me shkrim, të marrë nga kontrolluesi:

a) konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;

b) në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre;

c) në rastet e vendimeve automatike, sipas nenit 14 të këtij ligji, informacion për logjikën e përfshirë në vendimmarrje.

Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishte në kohën kur është bërë kërkesa.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

3. E drejta për akses, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse çënon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale.

4. E drejta e aksesit nuk mund të ushtrohet në rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji.

5. Në rast se aksesimi mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te Komisioneri.

Vendimmarrja automatike

1. Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.

2. Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas pikës 1 të këtij neni, kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.

E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

1. Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 6 të këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë t'i kërkojë kontrolluesit të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

E drejta për t'u ankuar

1. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

2. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Kompensimi i dëmit

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

5. Përgjegjësia për të njoftuar

5.1 Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

5.2 Përfshihet nga detyrimi për të njoftuar përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

5.3 Përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomikë ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Konfidencialiteti i të dhënave(neni 28)

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

II. Përpunimi i të dhënave sensitive

Rregulla të detyrueshme

1. Mbrojtja

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- ç) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, në përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret

Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse:

- a) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave;
- b) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave ose të një personi tjetër dhe subjekti i të dhënave është fizikisht ose mendërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e vet;
- c) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik;
- ç) lidhet me të dhëna, që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore;
- d) të dhënat përpunohen për kërkime shkencore ose statistikore;
- dh) të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor, sigurimit të kujdesit shëndetësor, kurimit, menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe përdorimi i tyre kryhet nga personeli mjekësor ose persona të tjerë, që kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- e) të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj;
- ë) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës.

Përpunimi i të dhënave sensitive, në rrethana të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për qëllime të interesave të rëndësishëm publikë, nën masa të përshtatshme mbrojtëse.

3. Siguria

3.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për

të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

3.2 Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;
- ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;
- d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar,
- dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
- e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;
- ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3.3 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.

3.4 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.5 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

3.6 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.

4. Zbatimi i të drejtave të subjekteve

4.1 E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave(neni 18)

4.2 E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave(neni 26 e 31)

4.3 E drejta për akses

4.4 E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

4.5 Vendimmarrja automatike

4.6 E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

4.7 E drejta për t'u ankuar

4.8 Kompensimi i dëmit

5. Përgjegjësia për të njoftuar

5.1 Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

5.2 Përjashtohet nga detyrimi për të njoftuar përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

5.3 Përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomikë ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

5.4 Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

III. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave

Rregulla të detyrueshme

1. Mbrojtja

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- ç) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, në përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret

2.1 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale

për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.2 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse:

- a) autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar;
- c) përbën detyrim për përmbushjen e një kontrate të përfunduar ndërmjet kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave ose një pale të tretë, në interesin e subjektit të të dhënave;
- ç) është detyrim ligjor i kontrolluesit;
- d) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;
- dh) është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;
- e) është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.

2.3 Shkëmbimi i të dhënave personale me përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja ose institucionet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë vlerësohet transferim ndërkombëtar.

Autorizimi

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të komisionerit.

Komisioneri, pasi bën vlerësimin, mund të japë autorizimin për transferimin e të dhënave personale në shtetin marrës, duke përcaktuar kushte dhe detyrime.

Komisioneri nxjerr udhëzime për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.

Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë.

3. Siguria

3.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

3.2 Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;
- c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;
- ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;
- d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar,
- dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;
- e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;
- ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3.3 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje

për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.

3.4 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.5 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

3.6 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.

4. Zbatimi i të drejtave të subjekteve

4.1 E drejta për tu informuar për mbledhjen e të dhënave(neni 18)

4.2 E drejta për tu njohur me regjistrin e mbrojtjes së të dhënave(neni 26 e 31)

4.3 E drejta për akses

4.4 E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

4.5 Vendimarrja automatike

4.6 E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

4.7 E drejta për t'u ankuar

4.8 Kompensimi i dëmit

5. Përgjegjësia për të njoftuar

5.1 Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

5.2 Përjashtohet nga detyrimi për të njoftuar përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

5.3 Përjashtohen nga detyrimi për të njoftuar të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomikë ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

5.4 Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

B. Mbrojtja e të dhënave nga Kontrollues të veçantë

Kontrollues të veçantë mund të jenë:

- Policia e Shtetit
- Policia Gjyqësore
- Prokuroria
- SHISH
- Gjykatat
- Organ i Sigurisë Kombëtare
- ILDKP, etj.

Statusi i kontrolluesit të veçantë

Përpunimi i të dhënave personale, të përcaktuara në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, për kryerjen e një vepre penale kundër rendit publik dhe të veprave të tjera në fushën e të drejtës penale, si dhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, kryhet nga autoritetet zyrtare të përcaktuara në ligj (neni 6 pika 2).

Rregulla përpunimi të detyrueshme

1. Mbrojtja (neni 5)

Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private(neni 2).

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

- a) në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme;
- b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- ç) në saktësinë nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, në përditësimin e kryerjen e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

2. Kriteret

Janë përcaktuar në Ligjet specifike të këtyre kontrolluesve të veçantë:

- Ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Kodi i Procedurës Penale.
- Ligji “Për Krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave ” .
- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e SHISH”.

Ligji nr.9887, datë 10.03.2009 “Per mbrojtjen e të dhënave personale në nenet 8 e 9 parashikon këto kritere:

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, aktet ligjore dhe

standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet nëse:

- a) autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- b) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar;
- c) përbën detyrim për përmbushjen e një kontrate të përfunduar ndërmjet kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave ose një pale të tretë, në interesin e subjektit të të dhënave;
- ç) është detyrim ligjor i kontrolluesit;
- d) është i nevojshëm për mbrojtjen e interesave jetësorë të subjektit të të dhënave;
- dh) është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik ose për ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore;
- e) është bërë nga një regjistër, i cili është i hapur për këshillime dhe siguron informacion për publikun në përgjithësi.

Shkëmbimi i të dhënave personale me përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja ose institucionet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë vlerësohet transferim ndërkombëtar.

Autorizimi

1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në raste të tjera nga ato të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, bëhet me autorizim të komisionerit.
2. Komisioneri, pasi bën vlerësimin, mund të japë autorizimin për transferimin e të dhënave personale në shtetin marrës, duke përcaktuar kushte dhe detyrime.
3. Komisioneri nxjerr udhëzime për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këto raste, kontrolluesi përjashtohet nga kërkesa për autorizim.
4. Kontrolluesi, përpara transferimit të të dhënave, bën kërkesë për autorizim te komisioneri. Në kërkesë kontrolluesi duhet të garantojë respektimin e interesave për ruajtjen e sekretit të subjektit të të dhënave jashtë Republikës së Shqipërisë.

3. Siguria(neni 27)

3.1 Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

3.2 Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;

b) përdorimi i të dhënave bëhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar;

c) udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave;

ç) ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar;

d) hyrja në të dhënat dhe programet bëhet vetëm nga personat e autorizuar,

dh) ndalon hyrjen në mjetet e arkivimit dhe përdorimin e tyre nga persona të paautorizuar;

e) vënia në punë e pajisjeve të përpunimit të të dhënave bëhet vetëm me autorizim dhe çdo mjet sigurohet me masa parandaluese ndaj vënies së autorizuar në punë;

ë) regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet etj.

3.3 Të dhënat e dokumentuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përjashtohet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një vepre penale.

3.4 Dokumentacioni i të dhënave mbahet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

3.5 Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.

3.6 Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit.(njihuni me këtë vendim në faqen tonë zyrtare info.idp.al)

4. Zbatimi i të drejtave të subjekteve

Për shkak të statusit të veçantë të këtyre institucioneve, nuk zbatohen të drejtat e parashikuara në nenet 18 dhe 12,15 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen (neni 13,19)

1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

Vendimmarrja automatike(neni 14)

1. Çdo person ka të drejtë të mos jetë subjekt i vendimeve, të cilat shkaktojnë efekte ligjore për të ose ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ai dhe kur vendimi është bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, që synojnë të vlerësojnë disa aspekte personale, që lidhen me të, veçanërisht, efektivitetin në punë, besueshmërinë ose sjelljen.

2. Një person mund të jetë subjekt i një vendimi të marrë, sipas pikës 1 të këtij neni, kur merren masa për të mbrojtur interesat e tij të ligjshëm, veçanërisht duke përfshirë në vendim këndvështrimet e tij.

E drejta për tu ankuar (neni 16)

1. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

2. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Kompensimi i dëmit(neni 17)

Çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

5. Konfidencialiteti i të dhënave

Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

C. Mbrojtja e të dhënave nga Autoriteti Mbikëqyrës

Sipas nenit 29 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” Komisioneri është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Si vihet në lëvizje zyra e Komisionerit?

Me nismën e individëve ose të Kontrolluesve:

- 1. Njëpërmjet Ankimit drejtuar Komisionerit** nga çdo subjekt i të dhënave personale, pra çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale në kundërshtim me këto parashikime të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”:
 - *Me fushën e zbatimit të ligjit (neni 4).*

- *Me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave(neni 5).*
 - *Me kriteret ligjore të përpunimit(neni 6).*
 - *Me përpunimin e të dhënave sensitive(neni 7).*
 - *Me përpunimin e për kërkime shkencore(neni 10).*
 - *Me përpunimin për qëllime të tjera(neni 11).*
 - *Me të drejtën për akses(neni 12).*
 - *Me të drejtën për të kërkuar korigjim e fshirje(neni 13).*
 - *Me vendimmarrjen automatike(neni 14).*
 - *Me të drejtën për të kundërshtuar(neni 15).*
 - *Me detyrimin për informim(neni 18).*
 - *Me detyrimin për korigjim ose fshirje(neni 19).*
 - *Me detyrimet e përpunuesit(neni 20).*
 - *Me përgjegjësinë për të njoftuar(neni 21).*
2. **Nëpërmjet Kërkesës për autorizim** nga Kontrolluesi apo individit (nenet 5,9,24 dhe 31)
 3. **Nëpërmjet kërkesave e ankimeve të tjera drejtuar Komisionerit,** të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 12/5).

Me nismën e vetë zyrës së Komisionerit:

- **Nëpërmjet shqyrtimit të njoftimeve që janë të detyruar të dërgojnë Kontrolluesit,** për të dhënat personale që ata përpunojnë(neni 21).
- **Nëpërmjet kontroleve të programuara nga zyra e Komisionerit, Hetimit administrativ dhe inspektimit** (nenet 29, 30).

Ç'Mund të bëjë Komisioneri pas konstatimit të shkeljes?

Nëse Zyra e Komisionerit, gjatë procesit të mbikëqyrjes gjen shkelje të ligjit ose akteve të tjera në këtë fushë, ka të drejtë të urdhërojë menjëherë si më poshtë:

- ✚ Kontrollin e ambjenteve, kompjuterave, pjsisjeve të tjera dhe dokumenteve teknike në të cilat janë përpunuar të dhënat personale, si dhe kontrollin e përmbajtjes së sistemit të të dhënave sipas kërkesave ligjore.
- ✚ Bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale.

- ✚ Ndalimin e transferimit të të dhënave personale tek një shtet i tretë ose shpërndarjen e të dhënave tek marrës të huaj, nëse kjo është në kundërshtim me ligjin.
- ✚ Kontrolluesit për korrigjimin dhe fshirjen e të dhënave personale, të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✚ Zbatimin e masave dhe procedurave të caktuara prej tij për sigurimin e të dhënave personale dhe shkallën e implementimit të tyre.
- ✚ Eliminimin e parregullsive për përpunimin e të dhënave personale, në kohën dhe mënyrën e përcaktuar prej tij, nëpërmjet udhëzimeve në sektorë të veçantë.
- ✚ Kryerjen e hetimit administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes.
- ✚ Kryerjen e kontrolleve të programuara për zbatimin e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale (nenet 1-28 dhe 39-41).
- ✚ Marrjen e masave të tjera të parashikuara nga ligji (rekomandime, etj).

Kur vërtetohen kushtet e parashikuara në nenin 30/2 të ligjit (*raste serioze, të përsëritura, moszbatim të përsëritur të rekomandimeve*), vendos sanksione administrative, sipas përcaktimeve në nenin 39 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Komisioneri me anë të specialistëve verifikon shkakun e vënies në lëvizje dhe kur e sheh me vend mund të ndërmarrë një hetim duke respektuar procedurën ligjore të parashikuar në nenet 46-104 të K.Pr.Administrative:

Hetimi administrativ

- a. Harton urdhërin e hetimit administrativ, ku përcaktohet baza ligjore, Kontrolluesi që hetohet, objekti i hetimit dhe personat që do të kryejnë hetimin.
- b. Paraqitja në selinë e kontrolluesit, parashtrimi i urdhërit të hetimit dhe fillimi i inspektimit. Konstatimi i shkeljes nëpërmjet mbajtjes së procesverbalit nga inspektorët e Drejtorisë së Hetim Inspektimit, ku të jetë shënuar identiteti i kundërvajtësit, lloji i kundërvajtjes administrative, nënshkrimi nga përpiluesi dhe përfaqësuesit e kontrolluesit, etj.
- c. Procesverbali, provat e mbledhura dhe relacioni i Drejtorisë së Hetim Inspektimit i nënshtrohet gjyqimit të Komisionerit.

ç. Në gjykimin e kundërvajtjes mund të marrë pjesë edhe Kontrolluesi ose përfaqësuesit e tij, të cilat nëpërmjet debatit, paraqesin pretendimet dhe prapsimet e tyre.

Sanksionet

Në përfundim të gjykimit, kur vërtetohet fajti, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 30/2 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Ne rast shkeljesh, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij), e konsideron shkeljen kundërvajtje administrative dhe sipas shkallës së fajtit dhe të rrethanave që kanë sjellë shkeljen vendoset dënimi i diferencuar i kundërvajtësit me gjobë, sipas përcaktimeve të sakta në pikat 1,2,3,4 të nenit 39 të këtij ligji.

Veç kësaj në dispozitën e sipërme është përcaktuar dhe e drejta e Komisionerit që për të njëjtat arsye “në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij” sipas shkallës së shkeljes që ta denoncojë publikisht ose ta raportojë çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave. Kjo është një tjetër garanci për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nga të gjithë kontrolluesit publikë dhe privat.

Po kështu, kur gjatë hetimit administrativ ose në përfundim të tij konstatohet se veprimet e kontrolluesit dhe përpunuesit apo punonjësve të tij përbëjnë vepër penale, atëherë Komisioneri e denoncon çështjen në organet dhe sipas kërkesave të nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale.

Rekomandimet

Jo gjithmonë nga ankesat apo investigimet e Komisionerit mund të ketë vend për vendosje të gjobës ndaj Kontrolluesve apo Përpunuesve. Në këto raste Komisioneri rekomandon rrugën ligjore që duhet të ndjekin ankuesit.

Veprimet e hollësishme të strukturës përkatëse të zyrës së Komisionerit për rastet e hetimit administrative parashikohen në rregulloren e brendshme të saj, si dhe në urdhërat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit.

Ëëbsiti i Komisionerit, www.idp.al, parashikon forma të kërkesës për ushtrimin e të drejtave të lartpërmendura dhe për përmbushjen e kërkesave përkatëse nga vetë Komisioneri.

Aktet ligjore e nënligjore në ndihmë të Komisionerit

Ligjet bazë për organizimin dhe funksionimin e zyrës së Komisionerit janë:

- Kushtetuta
- Aktet ndërkombëtare
- Ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”.
- Ligji nr.8792, datë 10.05.2001 “Për Krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave ”
- Ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
- Ligji nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”.
- Ligji nr.9614, datë 21.09.2006 “Për çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”.
- Ligji nr.7845, datë 13.07.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror”.
- Ligji nr.8389, datë 5.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”.
- Ligji nr.8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”.
- Ligji nr.10129, datë 11.15.2009 “Për gjendjen civile”, .
- Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligji nr.9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- Ligj për informacionin e klasifikuar, etj,etj.

Vendime të Këshillit të Ministrave

Nr. 134, datë 7.03.2003 “Për vërtetimin e legalizimin e dokumentave”,

Nr.596,datë 7.09.2006 “Për përdorimin, ruajtjen dhe adm. dok. Iden”,

Nr. 824 datë 06.12.2006 “Për miratimin e Institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, *si dhe të formularit të vetë deklarimit*” i ndryshuar,

Nr. 934, datë 2.9.2009 për “Përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes të së dhënave personale”.

Nr. 1232, datë 11.12.2009 për “Përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen”, etj.

Akte të Komisionerit

Vendime
Udhëzime
Rekomandime

Akte të tjera të rëndësishme

Përmbledhje të akteve të miratuara për institucionin
Komentari i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale
Përkttime të materialeve të huaja
Temat në Seminare
Temat në Workshope jashtë shtetit
Eksperienca e Autoriteteve homologe të Evropës e gjetkë
Vendime të Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese të vendit dhe të huaja për mbrojtjen e të dhënave personale
Rastet e zgjidhjeve të çështjeve të paraqitura Autoritetit Mbikëqyrës

Në mbyllje, kam bindjen se përdorimi në kohën e duhur dhe me efikasitet i këtij *Udhërrëfyese* do sjellë zbatimin rigoroz të kërkesave të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, kryesisht për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (POGAÇE)